



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA HIMARË

KËSHILLI BASHKIAK

Nr.2568prot.

Datë, më 21.03.2025

INFORMACION PËR VENDIMMARRJEN DHE PERFORMANCEN E KËSHILLIT TË BASHKISES HIMARË PËR VITIN 2024

Të nderuar këshilltarë!

Këshilli Bashkiak Himarë për vitin 2024 ka pasur një aktivitet jo shumë intensiv në vendimarrje për shkak të ndërrimit të titullarëve të Bashkisë si më poshtë vijon,

Këshilli Bashkiak në muajin mars pas dorëheqjes nga detyra të kryetarit të Bashkisë z. Jorgo Goro ka caktuar njërin nga dy nënkyetarët e Bashkisë për të ushtruar detyrën e kryetarit deri në zgjedhjen e kryetarit të ri , znj.Blerina Bala.

Në muajin qershor këshilli Bashkiak është detyruar të zhvillojë mbledhje jashtë radhe për të caktuar me vendim njërin nga dy nënkyetarët e Bashkisë Himarë pas dorëheqjes së parevokueshme të znj. BALA , Këshilli caktojë t'a ushtrojë këtë detyrë deri në zgjedhjen e kryetarit të ri z.Arqile Bollano.

Në muajin shtator Këshilli Bashkiak zhvillojë përsëri mbledhje jashtë radhe për të mbajtur ceremoninë e marrjes – dorëzimit të detyrës dhe kryerjen e betimit të kryetarit të Bashkisë Himarë z.Vangjel Tavo. Përpos ndryshimeve të titullarëve të Bashkisë, këshilli

ka qënë në komunikim të vazhdueshëm me komunitetin rrëth problematikave qe jane shfaqur.

Duke qënë se Këshilli si organ i vetëqeverisjes vendore në zbatim të ligjit ka rol vendimmarrës, përfaqësues , mbikqyrës dhe monitorues, jemi munduar të ushtrojmë këto role. Kemi mundur të

arrijmë objektivat duke zbatuar planin e aktivitetave të këshillit të miratuar për vitin 2024, duke u mbështetur në ligjin 139/2015 “ Për vetëqeverisjen vendore ”.

Duke pasur parasysh se shumë aktivitete të zhvilluara bëjnë pjesë në më shumë se një nga rolet e mësipërme të Këshillit po mundohemi në mënyrë të përmbledhur të japim aktivitetet kryesore të zhvilluara sipas kategorive.

Në lidhje me rolin vendimmarrës, janë kryer kryesisht aktivitetet si më poshtë:

Gjatë vitit 2024 janë realizuar në total 12 mbledhje të radhës të Këshillit Bashkiak dhe (2) mbledhje janë mbajtur jashtë radhe.

Në total janë miratuar (45) vendime ,të konfirmuara nga institucioni i Prefektit të Qarkut Vlorë janë (43) dhe (2) janë kthyer si të paligjshëm.

- Të gjitha mbledhjet e këshillit për transparencë te publiku janë zhvilluar live, të cilat janë transmetuar direkt nëpërmjet rrejetit social facebook me ndihmën e projektit “Bashki Të Forta” çka ka bërë që komuniteti të ndjekë direkt mbledhjen madje të japë dhe mendimet dhe sygjerimet e tij përvendimet dhe çështjet që janë shqyrtuar.

Për vitin 2024, Këshilli i Himarë ka miratuar një plan 1 vjeçar i aktivitetave të Këshillit i shoqëruar me buxhetin përkatës, i dedikuar vetëm për këshillin në mënyrë që të realizohen aktivitetet e planifikuara. Në këtë drejtim fondi i planifikuar për vitin 2024 eshte shpenzuar për aktivitetet e planifikuara, duke rritur eficiencën e shpenzimeve të këshillit.

Keshilli Bashkiak Himarë gjate viti 2024 me buxhetin e tij ka zhvilluar një vizitë në kuadrin e shkëmbimit të eksperiencave me këshillin dhe Bashkinë Eleousa e Metsovo , Janinë. Vizita studimore kishte për qëllim shkëmbimin e praktikave të mira , të cilat ndikojnë pozitivisht në rrjetjen e transparencës, si dhe ndarjen e eksperiencës që secili nga institucionet ka akumuluar , me qëllim përmirësimin e shërbimit ndaj qytetarëve.

Nga buxheti i Këshillit Bashkiak është realizuar trajnim i komisionit të financës, ekonomisë dhe i aditit në bashkëpunim me projektin Bashki të Forta ku kanë marrë pjesë anëtarët e komisionit Z. Gjergji Iliadhi dhe Z. Miltiadhi Prifti.

Këshilli ka funksionuar duke zbatuar 5 rregullore të cilat vendosin rregulla dhe standarte përushtimin e funksioneve të këtij organi si më poshtë:

- Rregullorja e Funksionimit të Këshillit të Bashksië.
- Rregullorja për Kodin e sjelljes dhe etikës së Këshillit të Bashksië.
- Rregullorja e trajtimit të ankesave/kërkesave dhe iniciativave/peticioneve.
- Rregullorja e marrëdheneve me komunitetin dhe mediat.

- Regullore për strukturat komunitare dhe ndërveprimi i tyre në Këshillin Bashkiak.

Këto rregullore përcaktojnë me detaje procedura dhe standarte për menyrën se si këshilli ushton tē gjitha funksionet e tij.

Sfida kryesore në këtë drejtim për vitin 2024 dhe në vazhdim, është implementimi i këtyre rregulloreve dhe planit tē aktiviteteve në praktikë. Për këtë qëllim është i nevojshëm bashkëpunimi i gjithë këshilltarëve, administrates si dhe komunitetit.

Në procesin e shqyrtimit dhe implementimit të këtyre rregulloreve këshilli është asistuar nga Projekti “Bashki tē Forta” tē cilët do vazhdojë edhe për këtë vit tē asistojë për tē bërë tē mundur implementimin e këtyre standardeve në mënyrë që tē rritet roli i Këshillit tē Himarë .

Rregullimi I faqes web duke azhornuar cdo aktivitet, sipas kerkesave te rregulloreve sipas modelit Bashki te Forta.

Në zbatim tē regulloreve tē miratuara është vënë në funksionim rregjistro fizik I Ankesave/Kérkesave si dhe rregjistro fizik I Inisiativave/Peticioneve, ku rregjistrohen dhe evidentohen te gjitha ankesat/kérkesat e mbritura në drejtim tē Këshillit Bashkiak. Konkretisht janë depozituar në total 23 kérkesa dhe 1 ankesë , 14 kérkesa i kanë kaluar për shqyrtim drejtive përkatëse , 3 prej tyre janë marrë vendime në këshill dhe 7 prej tyre nuk kanë qënë në kompetencë tē Këshillit . Kérkesat janë trajtuar dhe kordinuar me ekzekutivin e Bashkisë, dhe në tē gjitha rastet janë informuar qytetarët.

Në lidhje me rolin përfaqësues tē këshillit për vitin 2024 është synuar komunikimi dhe marrja e mendimeve tē komunitetit tē realizohet përmes komunikimit nëpërmjet publikimit në rrjetet sociale. Për tē realizur këtë qëllim është hapur adresa e Këshillit Bashkiak Himarë, facebook një faqe e dedikuar për aktivitetin e këshillit. Në këtë faqe janë publikuar aktivitetet e këshillit, konsultimet publike, njoftimi dhe rendi i ditës së mbledhjeve tē Këshillit,njoftimi i komisioneve tē këshillit,vendimet e kryesisë së Këshillit,rezantimi i projektbuxhetit për vitin 2025 e tē tjera. Nga vendimi i planit tē Këshillit me nr.51 datë 22.12.2023 janë miratuar 9 raporte dhe informacione tē cilat janë pasqyruar si informacione për këshillin nga administrata.

Në kuadër tē mbështetjes ndaj njësive tē vetëqeverisjes vendore dhe fuqizimit tē organeve vendimarrëse përmes rritjes së kapaciteteve tē këshilltarëve vendor është organizuar «Trajnim i përgatitor për komisionet e këshillit.

Në muajin Prill Aleanca e Grave Këshilltare Himarë ka zhvilluar një takim me kordinatorene projektit “ Bashki tē Forta” në njësinë Horë – Vranisht , fshati Tërbaç. Qëllimi i këtij diskutimi ishte me impakt në jetën e grave në Himarë dhe në fshatrat e administrimit tē saj .

Gjatë muajit tetor Kryesia këshillit në sallën e Bashkisë Himarë ka organizuar një takim në formë bashkëbisedimi me kryesitë dhe kryetarët e fshatrave të Bashkisë Himarë me qëllimin e mbarëvajtjes me sukses në detyrat dhe kompetencat që ata kanë në komunitet.

Në muajin tetor u mbajt një aktivitet në shëtitoren e Himarës kushtuar «Tetorit Rozë» , në bashkëpunim me administratën e bashkisë edhe «Aleanca e Grave të Këshillit Bashkiak Himarë» e cila përfaqësohej nga kryetarja e kësaj aleance znj.Afrovita Dhimojani dhe sekretarja Znj.Elena Memushaj, të cilat mbajtën dhe një fjalim përshëndetës dhe inkurajes për gratë e prekura ndaj kancerit të gjirit.

Në muajin nëntor në bashkëpunim me administratën Kryetari Këshillit Bashkiak z.Dhimitër Kapaj dekoroi me titullin « QYTETAR NDERI I BASHKISË HIMARË» z. Fatmir Toçi , vendim ky i marrë nga Këshilli i mëparshëm i vitit 2023.

Për sa u përket konsultimeve publike në zbatim të Rregullores së Konsultimeve Publike me ndihmën e Projektit Bashki të Forta kemi realizuar si fillim njoftimin në faqen e facebook të këshillit Bashkiak dhe takimet publike në të tria njësítë e Bashkisë për hartimin e buxhetit . Për marrjen e mendimeve të qytetarëve kjo dëgjesën u zhvillua në bashkëpunim të këshillit dhe Bashkisë.

Në njësinë Horë – Vranisht , më datë 05.12.2024

Në njësinë Lukovë , më datë 06.12.2024

Në Himarë , më datë 06.12.2024

Gjatë këtyre aktiviteteve të lart përmendura rekomandimet nga qytetarët u morën në konsideratë dhe u paraqitën në buxhetin e vitit 2025

Në lidhje me rolin mbikqyrës dhe monitorues të Këshillit, përveç ushtrimit të këtij roli nëpërmjet sqarimeve dhe pyetjeve të ezauruar nga ana e këshilltarëve në drejtum të administratës ne shqyrtimit të gjithë projekt vendimeve të propozuara nga ekzekutivi, në zbatim të planit të aktiviteteve të vitit 2024 u realizuan dhe u paraqitën në këshill 9, informacione dhe raporte nga administrata sipas kërkesave të bëra nga vetë këshilli,

Në këtë drejtim, duke qënë se edhe për vitin 2025, në planin e aktiviteteve të miratuar janë planifikuar një sëre informacionesh dhe raportesh nga të cilat një pjesë e mire janë edhe detyrime ligjore për t'u shqyrtuar nga këshilli, do ishte e nevojshme një bashkëpunim më i mirë me administratën dhe një angazhim më i madh për ekzekutivin, që të pregatisë në kohë raportet dhe informacionet e planikuara në planin e aktiviteteve të këshillit por edhe për rastet kur do të kërkohen nga këshilli.

Nga sa më sipër, duke ju falenderuar secilin për kontributin dhe angazhimin, si dhe duke falenderuar bashkëpunëtorët që asistojnë në aktivitetin e Këshillit të Bashksië Himarë, projektin “Bashkit të Forta”, ftojmë të gjithë të bëhen pjesë për përmirësimin e punës së këshillit nëpërmjet mendimeve dhe sygjerimeve tuaja.

Punë të mbarë dhe faleminderit !

SEKRETARE E KËSHILLIT BASHKIAK

ELENA MEMUSHAJ

A handwritten signature in black ink, appearing to read "Elena Memushaj". The signature is fluid and cursive, with a large, stylized 'E' at the beginning.